



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:250670
Datë: 07.05.2024
Numri i dokumentit: 05659922

C C.nr.4011/2023

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtari Uran Zogaj, në çështjen juridike kontestimore të paditësit R.B. nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson av. Xh.E. nga Prizreni, kundër të paditurit O.K. nga Prizreni, me objekt të kontestit vërtetimi i pronësisë, vlera e kontestit 3,500.00 euro, jashtë seancës gjyqësore, më datë 07.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. KONSTATOHET e tërhequr padia C.nr.4011/2023 e datës 17.11.2023, parashtruar nga paditësi R.B. nga Prizreni, kundër të paditurit O.K. nga Prizreni, për shkak të vërtetimit të pronësisë.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi R.B. nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson av. Xh.E. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi, kundër të paditurit O.K. nga Prizreni, me objekt të kontestit vërtetimi i pronësisë, vlera e kontestit 3,500.00 euro.

Lidhur me këtë çështje juridike kontestimore, i autorizuari i paditësit me parashtrësën C.nr.4011/2023 e datës 26.04.2024, ka njoftuar gjykatën se e tërheqin padinë në këtë çështje juridike kontestimore, pasi që palët ndërgjyqëse kanë arritur marrëveshje jashtëgjyqësore.

Mbi këtë bazë, gjykata vlerëson se janë plotësuar kushtet që të konstatohet e tërhequr padia e paditësit, në përputhje me nenin 261 të LPK-së. Kështu, në nenin 261 par. 1 të LPK-së theksohet që “paditësi mund ta tërheqë padinë pa pëlqimin e të paditurit deri në momentin në të cilin i padituri e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi”. Pastaj, me nenin 261 par. 3 të LPK-së përcaktohet se “po që se padia është tërhequr, gjykata jep aktvendim me të cilin konstatohet se është tërhequr padia”.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë në kuptim të nenit 450 të LPK-së, që secila palë t’i bartë shpenzimet e saj procedurale.

Nga sa u tha më lartë, konform dispozitave ligjore të parapara me nenin 261 dhe 387 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
C.nr.4011/2023 të datës 07.05.2024

Gjyqtari
Uran Zogaj

Numri i lëndës: 2023:250670
Datë: 07.05.2024
Numri i dokumentit: 05659922

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa në kuptim të nenit 261 par. 4 të LPK-së.